



KËSHILLI DREJTUES

**V E N D I M**

**Nr. 12, datë 28. 03. 2022**

**Për miratimin e “Raportit vjetor të  
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2021”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, të nenit 52 pika 1, shkronja (l) dhe të nenit 53, pika 5, shkronja (ë) të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 8, pika 2, shkronja “d” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Raportin Vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2021, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për paraqitjen e raportit vjetor pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi dhe të Raportit Vjetor në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

**Sekretare**

Donald Duraj

**Kryetar**